

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Pranuar më:	24 - 06 2020	
Primjeno:		
Njesia Jedinica	Numbri Broj	Shtoja Dodatak
1-400	- 25208	



MARRËVESHJE PËR BASHKËFINANCIM

Ndërmjet

Komunës së Lipjanit
me adresë rruga "Shqipëria" nr. 28,
Përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti arrijnë këtë:

Dhe

World Vision International
Adresa: RR. Lorenc Antoni, Nr.38, 10000 Prishtinë, Kosovë

Përfaqësuar nga Kledia Lika – Përfaqësuese ligjore

Palët bien dakord për çështjet si në vijim:

Neni I.
Dispozita të Përgjithshme



1. Palët pranojnë të nënshkruajnë këtë Marrëveshje për bashkëfinancim specifik të projektit "Krijimi i kabinetave të ITC në shkollat fillore" në njëmbdhjetë (11) shkolla fillore në fshatrat, Medvec, Magurë, Kraishtë, Puturoc, Gadime, Sllovi, Topliqanë, Ruboc, Smallushë, Babush i Muhaxherëve si dhe Lipjanë në shkollën fillore me instrumente muzikore- Komuna Lipjanit në fryshtë e besimit, respektit dhe të përgjegjësisë së ndërsjelltë.
2. Kjo Marrëveshje përkufizon qëllimin dhe vullnetin e dyanshëm të palëve për të bashkëpunuar dhe bashkëfinancuar projektin në fjalë.
3. Kjo Marrëveshje nuk kufizon të drejtën e ndonjerës nga Palët për të punuar në mënyrë të pavarur me organizata të tjera, që nënkupton se ky dokument përshkruan marrëdhënien e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit midis dy palëve vetëm për projektin specifik "Krijimi i kabinetave të ITC në shkollat fillore" në njëmbdhjetë (11) shkolla fillore në fshatrat, Medvec, Magurë, Kraishtë, Puturoc, Gadime, Sllovi, Topliqanë, Ruboc, Smallushë, Babush i Muhaxherëve si dhe Lipjanë në shkollën fillore me instrumente muzikore në Komunen e Lipjanit .

Neni 2. Qëllimi i Marrëveshjes së Bashkëfinancimit

I. Qëllimi i Marrëveshjes

Marrëveshja synon që përmes bashkëfinancimit mes Komunës së Lipjanit dhe World Vision International të realizohet projekti për "Krijimi i kabinetave të ITC në shkollat fillore" në njëmbdhjetë (11) shkolla fillore në fshatrat, Medvec, Magurë, Kraishtë, Puturoc, Gadime, Sllovi, Topliqanë, Ruboc, Smallushë, Babush i Muhaxherëve si dhe Lipjanë në shkollën fillore me instrumente muzikore - Komuna Lipjanit më qëllim të përmirësimit të kushteve bazë zhvillim të procesit mësimor.

Organizata World Vision International dhe Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan kanë identifikuar nevojën për ndërhyrje me këtë projekt dhe kanë shprehur gadishmëri të bashkëfinancojnë me Komunën e Lipjanit në Projektin: "Krijimi i kabinetave të ITC në shkollat fillore" në njëmbdhjetë fshatra (11) si në vijimë:

➤ Kabinetë shkollore për informatikë:

1. SHFMU "Fehmi Agani" – Medvec,
2. SHFMU "Haradin Bajrami" -Magurë,
3. SHFMU " Skënderbeu" – Kraishtë,
4. SHFMU "7 Marsi" -Puturoc,
5. SHFMU "Zenel Hajdini" – Gadime,
6. SHFMU " Hasan Zyko Kamberi"- Sllovi,
7. SHFMU "V. Damanaku"- Topliqan,
8. SHMU “Drita” Ruboc,
9. SHMU “Ibrahim Krasniqi”Smallushë,
10. SHMU “Ibrahim Krasniqi” Babush i Muhaxherëve

➤ Me nstrumente muzikore:

11. SHFMU “Ismail Luma” me instrumentet muzikore ne Lipjanë, në Komunën e Lipjanit.



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN



Neni 3. Baza ligjore

Kjo Marrëveshje për Bashkëfinancim të projektit në fjalë bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të Republikës së Kosovës, si dhe rrjedh si dokument mbështetës i "Marrëveshjes së Bashkëpunimit" mes World Vision International dhe Komunës së Lipjanit të nënshkruar më datë 17/10/2018, me numër protokoli: I-560-64265.

Neni 4. Përgjegjësitë dhe obligimet e palëve

Përgjegjësitë dhe obligimet financiare të Komunës së Lipjanit dhe organizatës World Vision International janë të detajuar në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

Përgjegjësitë dhe obligimet e Komunës se Lipjanit janë:

1. Komuna si implementues i projektit, do të zbatoj në tërësi projektin nga fillimi deri në mbarim duke i respektuar të gjitha rregullat e parapara me ligjet pozitive të Republikës së Kosovës.
2. Procedurat e prokurimit do të zhvillohen dhe udhëhiqen nga Komuna e Lipjanit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik.
3. Komuna e Lipjanit është përgjegjëse në zbatim të të gjitha fazave të nevojshme të projektit për krijuimi e kabinetave të ITC në shkollat fillore të cekura më lartë, të cilat pas realizimit nxënësit dhe stafi mësimdhënës i kësaj shkolle do të kenë qasje dhe kushte për zhvillim të mësimit.
4. Komuna është përgjegjëse për ndarjen e 20,000.00 EURO (përkatësisht financimin e fazës së dyte) nga kodi bashkëfinancim me donator për implementim të këtij nga shuma totale 49,000.00 Euro.
5. Pas fillimit të aktiviteteve të projektit, Komuna e Lipjanit do t'i paraqesë World Vision International raport finanziar brenda datës 10 Shtator 2020 në lidhje me zbatimin e projektit dhe shpenzimin e fondeve. Raportet financiare duhet të përfshijnë: faturat e shpenzimeve të projektit, dokumentacionet e tenderit, fotokopje të faturave, dokumenta të tjera mbështetës, të kompjutereve në shkolla përkatëse, krijuimin rrjetit të mbrendshëm dhe pasijen me programet adekuate për kabinetet e informatikës.

Përgjegjësitë dhe obligimet e World Vision International në Kosovë janë:

5. World Vision International do të ndajë 29,000.00 EURO, nga shuma totale 49,000.00 Euro, (përkatësisht fazën e parë), për realizimin e Projektit: Krijimi i kabinetave te ITC me kompjuter, rrjetin dhe isntalimin e tyre deri ne përdorim, për njëmbdhjetë (11) shkolla fillore në fshatrat, Medvec, Magurë, Kraishtë, Puturoc, Gadime, Sllovi, Topliqanë, Ruboc, Smallushë, Babush i Muaxhëreve si dhe Lipjanë në shkollën fillore me instrumente muzikore. Mjetet financiare të përmendura më lart, Organizata World Vision do t'i transferoj mjetet e cekuar me lartë në xhirologarinë e Komunës së Lipjanit:



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN



Perfituesi: **Komuna e Lipjanit**

Banka: **Banka Qendrore e Kosoves**

Nr. e kontos: **1000650150000190**

6. Bartja e mjeteve nga organizata World Vision International në llogarinë e Komunës së Lipjanit do të bëhet në dy këste:
 - Kësti i parë në shumë të 14,500.00 EURO do të bartet brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të marrëveshjes ne forëm parafinancimi.
 - Kësti i dytë në shumë të 14,500.00€, do të bartet ne forëm rimbursimi pas pranimit të raportit të punës dhe raportit financiar, nëse nuk ka ndonjë ngecje në procedura, përkatësisht brenda datës 15 Shtator, 2020.
7. World Vision International gjatë tërë procesit të pranim - dorëzimin kompjutërave në shkollat fillore do të monitorojë dhe do të bashkëpunojë ngushtë me organet komunale përkatëse për implementimin e projektit në tërsi.

Neni 5 Zbatimi i Marrëveshjes

Palët përgjigjen ndërsjelltas për përbushjen e detyrimeve dhe kushteve të **parashikuara** në këtë Marrëveshje Bashkëfinancirni, për të qenë partnerë në koordinimin e të dy fazave që do të garantojnë, realizimin e qëllimit specifik, gjegjësisht realizimin e projektit në fjalë.

Neni 6 Zgjidhjet e mosmarrëveshjeve

1. Në rast se në mes të palëve të kësaj Marrëveshjeje bashkëfinancimi, paraqiten paqartësi, vonesa të procedurave me baza ligjore, mospajtime apo për ndonjë arsyе tjetër, do të zgjidhen përmes bisedimeve.
2. Në rast të pakënaqësive të realizmit të punimeve bazuar në përshkrimin e projektit.
3. Nëse tentativat për zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve dhe pakënaqësive **nuk** kanë sukses, secila nga palët mund t'a ndërpresë këtë Marrëveshje bashkëfinancimi me pajtimin e të dy palëve. Njoftimi për ndërprerjen e Marrëveshjes së bashkëfinancimit duhet t'i dërgohet palës tjetër me shkrim, së paku një muaj para ndërprerjes efektive të saj.
4. Në rast të dështimit në zgjidhje të mosmarrëveshjeve dhe pakënaqësive në mënyrë **miqësore**, secila palë ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente.

Neni 7 Modifikimi i marrëveshjes apo shkëputja e saj

1. Kjo Marrëveshja për Bashkëfinancim mund të modifikohet apo të shfuqizohet në **mënyrë automatike** me hyrjen në fuqi të ndonjë ligji, fushëveprimi i të cilit prek ndonjë nga pikat e **kësaj marrëveshje**, apo aktet tjera nënligjore dispozitat e të cilave janë në kundërshtim me këtë Marrëveshje.
2. Çdo ndryshim eventual i kësaj marrëveshjeje do të shtohet si aneks dhe **hynë** në fuqi me nënshkrimin nga përfaqësuesit e institucioneve zbatuese të kësaj marrëveshjes.



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN



3. Secila nga palët mund të tërhiqet brenda tridhjetë (30) ditëve pas paralajmërimit me shkrim.
4. Kohë e paralajmërimit do të merret data e pranimit të letrës paralajmëruese.

Neni 8 Vizibiliteti


Nëse Komuna e Lipjanit organizon ose përfshihet në aktivitete promovuese të lidhura me këtë projekt, World Vision International duhet lajmëruar që më përpara. Çdo material apo aset i blerë me këto financime duhet të mbajë logon e World Vision International, ndërsa do të registrohen në listën e aseteve të Komunës.

Neni 9 Hyrja në Fuqi

1. Kjo Marrëveshje për bashkëfinancim nënshkruhet më datë 18/06/2019, në Komunën e Lipjanit, Republika e Kosovës, në dy (2) ekzemplar origjinale, nga një për së cilën palë nënshkruese.
2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet për një periudhë 4 mujore duke filluar nga momenti i nënshkrimit më: 15 Qershor, 2019, dhe do të jetë e vlefshme deri më: – 31 Dhjetor, 2020.

Palët nënshkruese

Për: Komunën e Lipjanit
z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës



Lipjan,
Datë: 24/06/2020

Për: World Vision International
znj. Kledia Lika – Përfaqësuese Ligjore


znj. Eljona Elmazi Drejtore Kombëtar

